



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1227/16 prot

Datë 02.09.2024

V E N D I M

Nr. 1172/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.09.2024 me

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1070/2024, datë 15.08.2024, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi*”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “*Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote*”
Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **54.589.104** (pesedhjetë e kater million e pesëqind e tetëdhjetë e nente mijë e njëqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **525.552 euro pa TVSH, Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024**, me objekt: “*Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore*”, me fond limit **LOT I MM1: 25.735.020** (njetëzetë e pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e njetëzetë) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues:	Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK me NIPT J62009007F dhe me adresë Rruga Dervish Hima-3 Kullat, K3, A9/2, Tiranë & BIOMETRIC ALBANIA SHPK me NIPT J61827062E dhe me adresë Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor:	Spitali Rajonal Durres me adresë Lagjia Nr.8, Rr.A.Goga , Durrës.
Subjekte të Interesuara:	Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK me NIPT K51612031J dhe me adresë Kashar Tirane Kashar, KASHAR, Autostrada "Tirane -Durrës", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 15.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1070/2024, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me nje operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “**Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **54.589.104** (pesedhjete e kater million e peseqind e tetedhjete e nente mije e njeqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **525.552 euro pa TVSH, Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024**, me objekt: “**Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore**”, me fond limit **LOT I MMI: 25.735.020** (njezete e pese milion e shtateqind e tridhjete e pese mije e njezete) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK duke e skualifikur këtë të fundit dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “MONTAL” SHPK & BIOMETRIC ALBANIA SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 742/8 prot., datë 28.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1227/13 prot., datë 02.09.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Spitali Rajnal Durrës administroi Vendimin tuaj nr.1070 datë 15.08.2024 protokolluar me tonën me nr. 742/4 prot., datë 21.08.2024. Referuar pikës 2 të dispozitivit, autoriteti kontraktor ngriti urdhërin nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024 për zbatimin e vendimit drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO). Në zbatim të urdhërit nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024, KVO përgatiti procesverbalin nr. 742/6 prot., datë 26.08.2024. Referuar pikës 3 të dispozitivit, autoriteti kontraktor, me qëllim lejimin për vazhdimin e veprimeve të mëtejshme, iu vë në dije për zbatimin e vendimit nr. 1070 datë 15.08.2024 protokolluar me tonën nr. 742/4 prot., datë 21.08.2024, duke dokumentuar edhe veprimet e kryera.....].

Bashkëlidhur:

-Procesverbalin e KVO-së nr. 742/6 prot., datë 26.08.2024;

-Urdhëri nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024 për zbatimin e vendimit;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 742/8 prot., datë 28.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1227/13 prot., datë 02.09.2024 autoriteti kontraktor, njofton se: [.....Spitali Rajnal Durrës administroi Vendimin tuaj nr.1070 datë 15.08.2024 protokolluar me tonën me nr. 742/4 prot., datë 21.08.2024. Referuar pikës 2 të dispozitivit, autoriteti kontraktor ngriti urdhërin nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024 për zbatimin e vendimit drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO). Në zbatim të urdhërit nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024, KVO përgatiti procesverbalin nr. 742/6 prot., datë 26.08.2024. Referuar pikës 3 të dispozitivit, autoriteti kontraktor, me qëllim lejimin për vazhdimin e veprimeve të mëtejshme, iu vë në dije për zbatimin e vendimit nr. 1070 datë 15.08.2024 protokolluar me tonën nr. 742/4 prot., datë 21.08.2024, duke dokumentuar edhe veprimet e kryera.....].

Bashkëlidhur:

-Procesverbalin e KVO-së nr. 742/6 prot., datë 26.08.2024;

-Urdhëri nr. 742/5 prot., datë 22.08.2024 për zbatimin e vendimit;

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1070/2024, datë 15.08.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor kreu rivlerësimin në

sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të ofertave, duke rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “MONTAL” SHPK, si dhe ka korrigjuar shkeljet e konstatuara për operatorin ekonomik ofertues, në zbatim të vendimit të KPP Nr. 1070/2024, datë 15.08.2024, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operatorë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi*”, me Nr. REF-97716-03-07-2024, me objekt: “**Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **54.589.104** (pesedhjetë e kater million e peseqind e tetedhjetë e nente mijë e njeqind e kater) leke pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **525.552 euro pa TVSH, Loti 1 me Nr. REF-97720-03-07-2024**, me objekt: “**Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore**”, me fond limit **LOT I MM1: 25.735.020** (njetete e pese milion e shtateqind e tridhjetë e pese mijë e njetete) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: **247.762 euro pa TVSH**, zhvilluar në datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri